



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SHA
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 24.03.2023

Drejtuar: Operatori ekonomik “SINTEZA CO” sh.p.k me NUIS K11324003F;

Me adresë: Rruga “Barrikadave”, Qendra “Turdiu”, Kati III/2, **Tiranë**.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-58591-02-09-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje shërbim printimi” me fond limit **2,900,000 (dy milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH**. Shërbimi do të ofrohet për **12 muaj** kalendarikë nga data fillimit të ofrimit të shërbimit, ose deri në ezaurimin e plotë të **3,200,000** fletëve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 13.02.2023, nr. **14**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “InfoSoft” sh.p.k me NUIS J62426002Q me vlerë të ofertës ekonomike 2,491,156 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik “SINTEZA CO” sh.p.k me NUIS K11324003F me vlerë të ofertës ekonomike 2,817,760 (dy milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I. Operatori ekonomik “InfoSoft” sh.p.k me NUIS: J62426002Q

a) Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.2.6, ku kërkohet: “*Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 5 (pesë teknikë) të certifikuar nga prodhuesi për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, nga të cilët 2 prej tyre inxhinierë elektronikë:*

- ✓ 1 inxhinier i certifikuar nga prodhuesi për instalimin dhe konfigurimin e softëare të menaxhimit të printimeve;
- ✓ 1 inxhinier i certifikuar me titullin MCSE ose ekuivalent;
- ✓ 1 punonjës i certifikuar për menaxhim projekti ITIL ose ekuivalent;
- ✓ 1 punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit

të vërtetuar me kontratën individuale të punës, dhe të jenë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi për periudhën Shtator - Dhjetor 2022”, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentat:

- ✓ Certifikatë nga Infolex S.A., për z. Artinel Zezo, për Lexmark X-series si “Teknik Servisi”;
- ✓ Certifikatë nga Info Technology Supply Ltd, për zgjidhjen PaperCut MF në instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje, për z. Bledi Qendro;
- ✓ Certifikatë për përmbushjen me sukses të kursit të trajnimit 20 CEU/CPE dhe 15.5 orë, ofruar nga CYBRARY në Cisco CCNA, për z. Bledi Qendro;
- ✓ Certifikatë për përmbushjen me sukses të kursit të trajnimit 20 CEU/CPE dhe 15.5 orë, ofruar nga CYBRARY në Cisco CCNA, për z. Frederik Prodan;
- ✓ Kontratë individuale pune për z. Artinel Zezo, me detyrën: Elektricitist për mirëmbajtje godine;
- ✓ Kontratë individuale pune për z. Bledi Qendro, shoqëruar me diplomë në Inxhinieri Elektronike;
- ✓ Kontratë individuale pune për z. Flavio Berberi, shoqëruar me Certifikatë nga Infolex për Lexmark X-series si “Teknik Servisi”;
- ✓ Kontratë individuale pune për z. Medrisi Kuka, me detyrën: Specialist rrjeti kompjuterik (Teknik pajisje multifunksionale printimi);

Nga këto dokumenta rezulton se:

- Ka vetëm një inxhinier elektronik të punësuar, z. Bledi Qendro (vërtetuar me diplomën përkatëse), nga dy të kërkuar në kriteret e kualifikimit;
- Operatori Ekonomik ka sjellë dokumenta për dy punonjës që kanë përfunduar një kurs të Cisco CCNA (nuk janë certifikime CCNA) i cili nuk është ekuivalent me asnjë nga certifikimet MCSE (mundëson përvetësimin e njohurive për mirëmbajtjen, konfigurimin dhe instalimin e produkteve të prodhuesit dhe të infrastrukturës së serverave) apo ITIL (tregon përvetësimin e njohurive për menaxhimin e shërbimeve, praktikave dhe përdorimin e proceseve në fushën e IT), të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Ka paraqitur 4 kontrata pune dhe nuk ka provuar se ka 5 (pesë teknikë) të certifikuar nga prodhuesi për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

- b) Në përmbushje të kriterit të kualifikimit 2.2.7, ku kërkohet: *”Operatori Ekonomik i cili ofron këtë zgjidhje duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose letër angazhimi ose akt marrëveshje bashkëpunimi, midis prodhuesit/ve ose distributorit dhe OE ofertes, për softëare të menaxhimit të printimeve. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”*, ka paraqitur Autorizimin nga prodhuesi ku vërtetohet që InfoSoft Office është një rishitës i autorizuar për programin softëare PaperCut, i cili nuk përmban të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, sikurse kërkohet në kriterin e vlerësimit.

Sa më sipër, operatori ekonomik “InfoSoft” sh.p.k., nuk i përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuar në dokumentat e tenderit (neni 82, VKM 285/2021), për rrjedhojë oferta e tij nuk kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“SINTEZA CO” sh.p.k me NUIS: K11324003F** me adresë: Rruga “Barrikadave”, Qendra “Turdiu”, Kati III/2, **Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të totale prej 2,817,760 (dy milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” SHA, Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vepronet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) - Nuk ka

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ardit Demiri